

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTERISE TIRANE
NOTERE PUBLIKE DENISA M. ÇELA
NR. 1800 REP.
NR. 44 KOL.

KONTRATE SHIT - BLERJE
(KUOTASH)

TAKSA E PULLES
U PAGUA

Ne Tirane, sot me date **13 Korrik 2018 (dymije e tetembedhete)**, perpara meje Noteres DENISA M. ÇELA, anetare e Dhomes se Notereve Tirane me adrese ne Rruga Reshit Çollaku, Pallatet Shallvare, Tirane u paraqiten palet e meposhtme kontraktuese dhe kerkuan redaktimin e kesaj kontrate shitblerje kuotash:

- **Z. RONI SHIMSHILASHVILI**, atesia Semion , shtetas izraeli, banues ne adresen Pallati Usluga, Rruga Reshit Petrela, lindur ne ish Bashkimi Sovjetik, me 11 Korrik 1993, mbajtes i pasaportes me nr. 21426946, madhor me zotesi te plote per te vepruar, njohes shume I mire I gjuhes angleze, asistuar ne perkthim nga perkthyesja e licensuar Znj. Jonida Tatazi (**ketu e meposhte referuar si “Shitesi”**);

DHE

- **Z. Pano ILIA**, atesia Vladimir, shtetas Shqiptar, lindur me 15.07.1996, ne Tirane dhe banues ne po aty, pajisur me Leternjoftim nr. 032736276 dhe nr. personal J 60715071 H, madhor me zotesi te plote per te vepruar, (**ketu e meposhte referuar si “Bleresi”**);

Secilit prej Paleve te lartpermendura do t'i referohemi si “Pale”, dhe bashkarisht do t'u referohemi si “Palet”. Palet e lartpermendura me identitetin e te cileve u njoha nga dokumentet qe ata dorezuan, dhe sipas Vendimit te Asamblese se Shoqerise dhe sipas Ekstrakit te nxjerre nga QKB, kane tagra te plota per te vepruar dhe per te hyre ne kete Kontrate . Te dyja palet, personalisht me bene me dije, duke ushtruar vullnetin e tyre te lire, qe duan te lidhin kete marreveshje per Shit - Blerjen e kuotave (“Kontrata e Shit-Blerjes se Kuotave”), si me poshte vijon:

Te pergjithshme

A.Shitesi eshte zoterues i 1 (nje) kuote, e cila perfaqeson 100% te kapitalit, me vlere 100 (njeqind) Leke, ne Shoqerine “RBH SOFTWARE MARKETING SOLUTIONS” shpk (me poshte referuar si “Shoqeria”). Shoqeria eshte rregjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 08/02/2018, me numer NUIS L81408038U dhe ka si objekt kryesor ne fushen e kerkimeve te marketingut online. Aktivitet ne fushen e marketingut ne Web. Kryerjen e hulumtimeve te marketingut. Marrja e informacionit nga tregu. Aktivitete call - center,thirrje ne web etj. Kapitali i shoqerise eshte **100 (njeqind) leke**.

B. Shitesi deshiron t'i shese Bleresit 100 % te kuotave qe zoteron ne kete shoqeri dhe Bleresi deshiron te bleje sipas kushteve dhe afateve te kesaj kontrate dhe pas kalimit te kuotave behet pronar ne masen 100% te shoqerise "RBH SOFTWARE MARKETING SOLUTIONS" shpk.

C. Ne perputhje me nenin 117 pika b "Menyrat e fitimit dhe kalimit te kuotave", te Ligjit Nr. 9901, date 14.04.2008 « Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare », neni 705 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise "Dispozitat e Pergjithshme per kontraten e shitjes", dhe ne pergjithesi te legjislacionit shqiptar ne fuqi, hartohet kontrata e shitjes se kuotave si me poshte vijon:

Neni 1

Objekti

Ne perputhje me afatet dhe kushtet e percaktuara ne kete kontrate, Shitesi i kalon nepermjet shitblerjes se 100 % te kapitalit te zoteruar ne shoqeri, si dhe te drejten e pronesisë mbi 100% te kuotave dhe te drejtat e tjera te lidhura me kete pjesemarrje Bleresit, duke e garantuar plotesisht titullin e pronesisë te pa renduar me barre dhe Bleresi nga ana tjetër blen nga Shitesi kuotat kundrejt nje çmimi te percaktuar ne nenin 2 te kesaj kontrate.

Neni 2

Çmimi i Shitjes

2.1. Çmimi i plote i shitjes se 100% te kuotave qe **Z. Roni SHIMSHILASHVILI** tjeterson/shet ne favor te Z. Pano Ilia eshte ne vleren prej **100 Leke (njqind leke)**.

Neni 3

Pagesa

3.1. Çmimi eshte paguar nga Bleresi Z. Pano Ilia ne favor te Shitesit Z. Roni SHIMSHILASHVILI. Kjo Kontrate do te regjistrohet ne QKB, me qellim kalimin e pronesisë ne favor te Z. Pano Ilia, me nenshkrimin e kesaj Kontrate.

Neni 4

Kalimi i pronesisë se ligjshme mbi kuotat

4.1 Kalimi i pronesisë se ligjshme mbi kuotat nga Shitesi te Bleresi do te kryhet menjehere me nenshkrimin e kontrates dhe vetem pas kryerjes se pageses se plote te cmimit te blerjes prej 100 Leke (njqind leke).

Neni 5

Garancite

Shitesi ne lidhje me kuotat qe zoteron, garanton Bleresin:

5.1. Se eshte pronar i vetem i kuotave te shitura e nuk ekzistojne te drejta te parablerjes, te blerjes, te marrjes ose te opsionit te ndonje personi te trete ne lidhje me kuotat e shitura.

5.2. Se e drejta per perfitimin e dividendit mbi kuotat e fituara ne shoqerine do te mund te ushtrohet rregullisht.

5.3. Te gjitha te mirat ekonomike te perdorura nga shoqeria, te cilat jane te nevojshme ose te dobishme per aktivitetin ekonomik te shoqerise dhe per vazhdimin e pakufizuar te tyre pas dites

se lidhjes se Kontrates se Shitblerjes se Kuotave , veçanerisht objektet pasurore jane ne pronen e vetme e shoqerise dhe nuk jane ngarkuar me te drejta ose pretendime te te treteve.

Neni 6

Regjistrimi

6.1 Kjo kontrate duhet te depozitohet brenda 30 diteve prane Qendres Kombetare te Biznesit, me qellim reflektimin e ndryshime te struktures se ortakerise se Shoqerise prane ketij regjistri.

6.2 Regjistrimi i kalimit te kuotave nga Shitesi te Bleresi ne Qendren Kombetare te Biznesit do te kryhet vetem pas likujdimit te plote te cmimit te blerjes se kuotes, e cila perfaqeson 100% te kapitalit te Shoqerise RBH SOFTWARE MARKETING SOLUTIONS SHPK.

Neni 7

Ligji i zbatueshem

7.1. Kjo kontrate rregullohet nga ligji nr. 9901 date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, neni 705 e vijues te Kodit Civil te Republikes se Shqiperise, Ligji “Per Qendren Kombetare te Biznesit” si dhe perkatesisht dispozitat e aktit te themelimit dhe Statutit te Shoqerise.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

8.1. Palet do te perpiqen te zgjidhin me mirekuptim çdo mosmarreveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kesaj kontrate, ne te kundert juridiksioni kompetent do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor te Tirane.

Neni 9

Te ndryshme

Nenet e pergjithshme jane pjese e pandare e kesaj kontrate.

Kjo kontrate mund te ndryshoje vetem me pelqimin e te dyja paleve duke respektuar formen shkresore te noterizuar.

Per sa me siper, ky akt hartohet nga une noterja ne 4 (kater) ekzemplare me vlere te njejte ligjore dhe kuptimore, referuar vullnetit te paleve nenshkruese dhe ligjit, ne perputhje te plote me Ligjin nr. 7829, date 01.06.1994 “Per Noterine”, vertetoj nenshkrimin e tyre, ne pranine e perkthyesit te gjuhes Angleze. Ne zbatim te ligjit 9887, date 10.03.2008 “Per mbrojtjen e te dhenave Personale”, une Noteria deklaroi se do te ruaj dhe perpunoj te dhenat personale te subjektit te kesaj deklarate, ne menyre te drejte dhe te ligjshme.

SHITESI

Z. Roni SHIMSHILASHVILI

BLERESI

Z. Pano ILIA

Roni Shimshtilashvili

NOTERE PUBLIKE
DENISA M. CELA

Pano Ilia



RBS
Regjistri i Barrëve Siguruese

Rr. e Dibrës, Qendra e Biznesit AK,
"Selvia" Kati V
TIRANE, SHQIPERË
TEL/FAX: 355 4 2420005
TEL: 355 4 2420006
Email: rbs@roen-al.com

REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit të Kerkimit: D-20180712121233960
Data e Rezultatit të Kerkimit: 12.07.2018
Ora e Rezultatit të Kerkimit: 12:12:34PM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-687-729
Referenca e Perdoruesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

RONI SEMION SHIMSHILASHVILI
RBH SOFTWARE MARKETING SOLUTIONS



Trë Dibrë

